



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-067

Prishtinë, më 10 gusht 2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 10 GUSHT 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Slobodan Petroviq dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Pal Lekaj, Slavko Simiq dhe Valdete Bajrami.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili, Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha dhe Shefki Shoshaj.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 korrik 2016,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 korrik 2016

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 korrik 2016.

2. Përgatitjet për seancë plenare

Në fillim, Kryetari i Kuvendit i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Pal Lekaj, që t'i lejohet pjesëmarrja e Kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj, si mysafir në seancën plenare, kur do të shqyrtohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë për përgatitjen e rendit të ditës, për secilën pikë veç e veç, për seancën plenare të radhës.

Pastaj, Kryetari e hapi diskutimin për caktimin e datës për mbajtjen e seancës plenare.

Lidhur me përgatitjet e punimeve të seancës plenare diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli; Valdete Bajrami, kryetare e GP të Nismës për Kosovën; Glauk Konjufca, kryetar i GP të Lëvizjes Vetëvendosje; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Gjatë zhvillimit të diskutimeve, kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca, hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

* * *

Pas një pauze të shkurtër, Kryesia e Kuvendit e vazhdoi mbledhjen në sallën S-1.

Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje nuk ishte i pranishëm në këtë pjesë të mbledhjes së Kryesisë.

Kryetari i procedoi diskutimet lidhur për caktimin e datës dhe të rendit të ditës për seancë plenare.

Kryetari i GP të LDK-së, z. Ismet Beqiri, propozoi që shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të bëhet në procedurë të rregullt, e jo me shmangie nga afatet procedurale.

Propozimin e kryetarit të GP të LDK-së e mbështeti edhe kryetari i GP të PDK-së, z. Adem Grabovci.

Lidhur me caktimin e datës dhe të rendit të ditës për seancë plenare diskutuan edhe kryetari i GP të AAK-së, z. Pal Lekaj dhe kryetarja e GP të Nismës, znj. Valdete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkrip.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të GP të PDK-së, z. Adem Grabovci dhe të GP të LDK-së, z. Ismet Beqiri, ndërsa kundër ishin kryetari i GP të AAK-së, z. Pal Lekaj dhe kryetarja e GP të Nismës për Kosovën, znj. Valdete Bajrami, vendosi që seanca plenare të mbahet të enjten, më 1 shtator 2016, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Interpelanca e Kryeministrit, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 7 deputetë nënshkrues, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,
5. Interpelanca e Kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Ismajl Kurteshi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi,
7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015,
8. Propozimi i GP të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

* * *

Gjithashtu, ndërkohë edhe ndonjë pikë tjetër që i plotëson kushtet formale mund të radhitet në rend dite të seancës plenare më 1 shtator 2016.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Propozimi i kryetarit të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, z. Xhavit Haliti, për miratimin e Rregullores së punës së këtij komisioni

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, e miratoi Rregulloren e punës së Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE- Kosovë.

2. Shqyrtimi i Propozim-Rregullores për mbrojtje nga zjarri

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, e miratoi Rregulloren për mbrojtje nga zjarri.

3. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2016

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e raportit të shpenzimeve për periudhën prill-qershor 2016 dhe Programin e shpenzimeve për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2016 të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe me rekomandimin e bërë Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, për transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në llogarinë e RTK-së, nr. 1110101219060187, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2016, në shumën prej 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) euro.

4. Kërkesa e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për lejimin e pagesës së shpenzimeve të fjetjes për delegacionin nga Universiteti i Zagrebit, të cilët kanë qëndruar në Hotelin Swiss Diamond në Prishtinë, më 23 qershor 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Lejohet pagesa e mjeteve në shumë prej 435 (katërqind e tridhjetë e pesë) euro, për shpenzimet e fjetjes të delegacionit tre (3) anëtarësh nga Universiteti i Zagrebit, të cilët kanë qëndruar në Hotelin Swiss Diamond në Prishtinë, më 23 qershor 2016, sipas faturës nr. 11154259 të bashkangjitur.

5. Kërkesa e deputetit Kujtim Paçaku për lejimin e udhëtimit zyrtar në Letoni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kujtim Paçaku, për të marrë pjesë në Kongresin e nëntë (9) për Ditën botërore të romëve, i cili do të mbahet në Riga të Letonisë, nga data 17 deri më 21 gusht 2016.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet shtesë mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Kërkesa e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa në shumën prej pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë (5650) euro, për mbështetje financiare Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për mbajtjen e një punëtorie 5-ditore, në të cilën do të marrin pjesë 50 persona nga komuniteti i të verbërve të Kosovës.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

7. Kërkesa e kryetarit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa në shumën prej tre mijë (3000) euro për mbështetje financiare Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë për realizimin e projektit që ka të bëjë me monitorimin e institucioneve korrektuese, qendrave të ndalimit dhe të paraburgimit.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

8. Kërkesa e deputetit Besim Beqaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Izrael

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Besim Beqaj në Izrael, nga data 06-08 shtator 2016.
2. Shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet shtesë për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Kërkesa për ndihmë financiare e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa në shumën prej tre mijë (3000) euro, për mbështetje financiare, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, dega në Vushtrri, për ndërtimin e bustit të Kryekomandantit të Lëvizjes kaçake të Drenicës, Heroit Kombëtar, Azem Bejta.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

10. Kërkesa për ndihmë financiare e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, dega në Malishevë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet pagesa në shumën prej tre mijë (3000) euro për mbështetje financiare Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, dega në Malishevë, për ndërtimin e bustit të Dëshmorit të Kombit, Habib Zogaj, nga fshati Lladroc, Malishevë.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.

11. Njoftimi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës lidhur me ndarjen e një parcele për ndërtimin e shtëpisë së familjarëve të ish-pjesëtarit të ndjerë të FSK-së, tetar Lavdim Ademi

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me shkresën e Komunës së Mitrovicës drejtuar Kuvendit të Kosovës për pranimin e kërkesës nga ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës për ndarjen e një parcele nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës për ndërtimin e shtëpisë familjarëve të pjesëtarit tani të ndjerë të FSK-së, Lavdim Ademi.

Kryetari tha se shuma e mjeteve prej 20.000 € të parapara për ndërtimin e objektit të banimit ndërlidhet edhe me vendimin e seancës plenare për shënimin e 5 Shtatorit “Dita e Bamirësisë”.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

VENDIM

Për ndërtimin e shtëpisë familjes së ish-pjesëtarit të ndjerë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, tetar Lavdim Ademi, në parcelën e ndarë nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës, të ndahen mjete financiare nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës në shumën prej 20,000 (njëzet mijë) eurosh.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale